**VENDIM**
**Nr. 90, datë 31.5.2019**

# MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E DRAFTKONTRATËS NDËRMJET KESH SHA DHE OSHEE SHA, PËR SHITBLERJEN E SASISË SË TEPËRT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË REZULTON PAS PËRMBUSHJES SË KËRKESËS SË KLIENTËVE QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI UNIVERSAL ME QËLLIM MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR PERIUDHËN KOHORE 1.1.2019–31.12.2019

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 5 të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016,"Për miratimin e "Kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit transmetimi, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", i ndryshuar; nenit 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, lidhur me "Fillimin e procedurës për miratimin e draftkontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019",

konstatoi se:

- Në shkresat me nr. 2264/1 prot., dhe nr. 2264 prot., datë 13.5.2019, protokolluar me tonat nr. 340/1, datë 15.5.2019 dhe nr. 340, datë 15.5.2019, është paraqitur për miratim pranë ERE-s, "draftkontata ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019".

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 16, datë 18.2.2019 mbi "Shtyrjen e afatit të zbatimit të "Kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/OSHEE sh.a. për periudhën 1.1.2018–31.12.2018", dhe "Kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018", pika 1 e tij vendosi:

*1. Shtyrjen e afatit të zbatimit të Kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 98, datë 30.4.2018, deri në paraqitjen e draftkontratës për vitin 2019 nga KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., dhe miratimin e saj nga ERE.*

- Me shkresën me nr. 176/1 prot., datë 6.3.2019 dërguar shoqërive KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., ERE ka bërë me dije palët se: "shtyrja e afatit të kontratave të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 16, datë 18.2.2019 erdhi si rrjedhojë e konstatimeve mbi mungesën e dakordësisë mes palëve për nënshkrimin e kontratave të vitit 2019.

- Gjithashtu, në korrespondencën sa më sipër cituar, ERE u ka bërë me dije palëve se mungesa e kontratave të dakordesuara nuk i çliron palët (KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a.) nga detyrimi për të depozituar në ERE për miratim këto kontrata në përmbushje të parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

- Në përgjigje të korrespondencës sa më sipër, u paraqit për miratim në ERE "draftkontrata ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019.

- Nga shqyrtimi i kontratës së paraqitur dhe të dakordësuar e nënshkruar mes OSHEE sh.a. dhe KESH sh.a., për vitin 2019 konstatojmë se ka ndryshime nga kontrata e miratuar më 2018-n, të cilat konsistojnë në nenin 4.

Në konkluzion duke konstatuar:

- të drejtën e ERE-s për miratimin e kontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019" në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 5 të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016,"Për miratimin e "Kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit transmetimi, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", i ndryshuar; dhe nenit 26 të "Rregullave të organizimit dhe funksionimit të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, i propozojmë Bordit të ERE-s:

- dakortësinë e palëve me njëra-tjetrën mbi "Kontratën ndërmjet "KESH"sha dhe "OSHEE"sha, për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019", e pasqyruar kjo në nënshkrimin e saj nga palët.

- KESH sh.a. legjitimohet si palë në rolin e prodhuesit të energjisë elektrike dhe OSHEE sh.a. në rolin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë elektrike.

- Për ndryshimet e konstatuara në kontratë që konsistojnë në neni 4, do t'u kërkohet informacion palëve lidhur me arsyet e ndryshimeve dhe përputhshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e "Kontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019".

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**